

## Hyrje

Raporti i punës së Këshillit të komunës së Tearcës bazohet në aktet juridike të miratuara nga Këshilli komunal për periudhën njëvjeçare.

Ky Raport përmbledh punën e Këshillit të komunës në të gjitha aspektet e tij dhe përmban informacion të konsoliduar dhe të dhëna mbi punën njëvjeçare të Këshillit komunal, duke përfshirë të gjitha sukseset, por edhe duke shënuar pengesat kryesore në këtë periudhë kohore.

Puna njëvjeçare e Këshillit komunal mund të konsiderohet e suksesshme dhe dëshmi e këtij sukcesi është komunikimi i vazhdueshëm dhe i shkëlqyer mes anëtarëve të Këshillit komunal, përkrahja e kërkesave të ligjshme të qytetarëve, bashkësive lokale, shoqatave qytetare, etj.

Respektimi i dallimeve kulturore, etnike, fetare, politike, etj, gjithashtu përbën bazën e suksesit dhe mbarëvajtjes së punës në Këshillin komunal. Sukses tjetër është edhe koordinimi i rregullt i mbajtur me grupet e këshilltarëve, komunikimi i vazhdueshëm me administratën komunale dhe institucionet tjera të themeluara nga komuna si shkollat fillore komunale, ndërmarrjen publike, etj.

Në këtë periudhë njëvjeçare kemi miratuar shumë vendime, programe, plane vjetore, strategji lokale, konkluzione, si dhe akte tjera juridike të cilat kanë si qëllim t'a shndërojnë Këshillin komunal në institucion ku vendoset mbi perspektivën dhe fatin e qytetarëve.

Të gjitha akte juridike të miratuara nga Këshilli komunal janë të shpallura në "Fletoren zyrtare të komunës së Tearcës" dhe çdo qytetarë ka të drejtë të ketë qasje në atë dokument zyrtar.

## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS


Emri dhe mbiemri	Pozita e të zgjedhurit	Vendbanimi	Partia politike (koalicioni)
Besnik Osmani	Kryetar i Këshillit	f.Nerasht	Bashkimi Demokratik për Integrim-BDI
Genc Misimi	Këshilltar	f.Sllatinë	Bashkimi Demokratik për Integrim-BDI
Gjulten Qazimi	Këshilltare	f.Përshefc	Bashkimi Demokratik për Integrim-BDI
Festim Elmazi	Këshilltar	f.Dobrosht	Bashkimi Demokratik për Integrim-BDI
Erzen Elezi	Këshilltar	f.Glllogjë	Bashkimi Demokratik për Integrim-BDI
Valmira Selimi	Këshilltare	f.Odër	Bashkimi Demokratik për Integrim-BDI
Rijad Mustafi	Këshilltar	f.Neproshten	Bashkimi Demokratik për Integrim-BDI
Arian Hakiki	Këshilltar	f.Nerasht	Koalicioni Aleanca për shqiptarët dhe Alternativa
Gzim Azemi	Këshilltar	f.Dobrosht	Koalicioni Aleanca për shqiptarët dhe Alternativa
Arjeta Shasivari	Këshilltare	f.Përshefc	Koalicioni Aleanca për shqiptarët dhe Alternativa
Valon Idrizi	Këshilltar	f.Sllatinë	Koalicioni Aleanca për shqiptarët dhe Alternativa
Imer Imeri	Këshilltar	f.Sllatinë	Partia Demokratike Shqiptare-PDSH
Sezgin Sherifi	Këshilltar	f.Tearcë	Partia Demokratike Shqiptare-PDSH
Amet Ziberi	Këshilltar	f.Odër	Lëvizja BESA
Rami Selmani	Këshilltar	f.Nerasht	Lëvizja BESA
Nesrine Qazimi	Këshilltare	f.Përshefc	Lëvizja BESA
Oliver Georgjevski	Këshilltar	f.Tearcë	VMRO-DPMNE dhe Koalicioni “Përtëritja e Maqedonisë”
Ilčo Tofilovski	Këshilltar	f.Tearcë	Koalicioni “Më e mira për komunën time”-Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë-LSDM
Metin Useini	Këshilltar	f.Tearcë	Partia Demokratike e Turqve të Maqedonisë-PDTM

### Përbërja partiake e Këshillit


Partia politike (koalicioni)	Numri i anëtarëve
Bashkimi Demokratik për Integrim-BDI	7
Koalicioni Aleanca për shqiptarët dhe Alternativa	4
Partia Demokratike Shqiptare -PDSH	2
Lëvizja BESA	3
VMRO-DPMNE dhe Koalicioni “Përtëritja e Maqedonisë”	1
Koalicioni “Më e mira për komunën time”-Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë-LSDM	1
Partia Demokratike e Turqve të Maqedonisë-PDTM	1

# KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

Struktura etnike e Këshillit komunal



Përfaqësimi gjinor në Këshillin komunal



Këshilli i komunës së Tearcës e përbëjnë gjithsej 19 anëtarë. Në Këshill janë të përfshira 7 parti politike dhe koalicione. Anëtarët e Këshillit janë zgjedhur nga banorët e komunës së Tearcës në zgjedhje të drejtëpërdrejta dhe demokratike me mandat katër vjeçar.


Këshilli harton dhe dikton politikën e komunës, miraton Buxhetin e komunës, llogarinë përfundimtare, miraton vendime, programe, raporte, rregullore si dhe akte tjera juridike.

Nga data 16.11.2021, kur edhe u zgjodh përbërja e re e Këshillit, e deri më 15.11.2022, Këshilli i komunës së Tearcës ka mbajtur gjithsejt 14 seanca të rregullta dhe asnjë të jashtëzakonshme.


Aktet e miratuara nga Këshilli i komunës së Tearcës në vitin 2021/22

Buxhet	1
Llogari përfundimtare	1
Vendime	98
Programe	16
Raporte	2
Përfundime	16
Rregullore	2
Konkluzione	2
Strategji lokale	1
Plan Operativ	2
Plan vjetor	1
Rebalans	2
Plan aksional	1
Procesverbale	13

Akte të miratuara



Aktet e miratuara



### AKTET E MIRATUARA NGA KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

Nr.	Akti i miratuar	Procedurë	Data
1.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit verifikues për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit të komunës së Tearcës.	rregullt	16.11.2021
2.	<b>Vendim</b> për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit të komunës së Tearcës.	rregullt	16.11.2021
3.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Kandidues për propozimin e kandidatit për Kryetar të Këshillit	rregullt	16.11.2021
4.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit të komunës së Tearcës.	rregullt	16.11.2021
5.	<b>Vendim</b> për caktimin e këshilltarëve të autorizuar për lidhjen e martesave.	rregullt	16.11.2021
6.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërimë.	rregullt	16.11.2021
7.	<b>Vendim</b> zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për financa, buxhet dhe zhvillim ekonomik lokal.	rregullt	29.11.2021
8.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Statutar-juridik.	rregullt	29.11.2021
9.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për arsim.	rregullt	29.11.2021
10.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për mundësi të njëjta mes grave dhe burrave.	rregullt	29.11.2021
11.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për planifikim dhe rregullimin e hapësirës dhe mbrojtjen e ambientit jetësor.	rregullt	29.11.2021
12.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për punë komunale dhe komunikacion.	rregullt	29.11.2021
13.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për veprimtari shoqërore.	rregullt	29.11.2021
14.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për dhurata dhe mirënjohje.	rregullt	29.11.2021
15.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit mbikqyrës për kontrollë të punëve materialo-financiare.	rregullt	29.11.2021

## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

16.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive në komunën e Tearcës.	rregullt	29.11.2021
17.	<b>Vendim</b> për pushimin e mandatit të përfaqësuesve të Këshillit të komunës së Tearcës në organet drejtuese të SHFK në territorin e komunës së Tearcës.	rregullt	29.11.2021
18.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit të komunës së Tearcës në Këshillin e shkollës të shkollave fillore komunale në territorin e komunës së Tearcës.	rregullt	29.11.2021
19.	<b>Vendim</b> për caktimin e brezit buzë bregut të rrjedhjes së ujit për lumenjtë në atarin e komunës së Tearcës.	rregullt	29.11.2021
20.	<b>Vendim</b> për zgjerimin e mjeteve nga Buxheti i komunës së Tearcës për vitin 2021.	rregullt	29.11.2021
21.	<b>Vendim</b> për themelimin e departamentit të përbashkët për menaxhimin e ujit dhe rreziqet nga përmbytjet me komunat Bërvenicë, Vrapçisht, Gostivar, Bogovinjë, Jegunovc, Mavrovë dhe Rostushë, Tetovë, Tearcë dhe Zhelinë.	rregullt	17.12.2021
22.	<b>Vendim</b> për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit drejtues të NP "Higjiena"-Tearcë.	rregullt	17.12.2021
23.	<b>Vendim</b> për zgjerimin e mjeteve të Buxhetit të komunës së Tearcës për vitin 2021.	rregullt	17.12.2021
24.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit drejtues të NP "Higjiena"-Tearcë.	rregullt	17.12.2021
25.	<b>Vendim</b> për zgjedhje të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit përpilimin e Programës për punën e Këshillit të komunës së Tearcës.	rregullt	17.12.2021
26.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal për preventivë.	rregullt	17.12.2021
27.	<b>Vendim</b> për formimin e Komisionit për mbrojtje shëndetësore, mbrojtje sociale dhe mbrojtje të fëmijëve.	rregullt	17.12.2021
28.	<b>Vendim</b> për zgjedhje të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për mbrojtje shëndetësore, mbrojtje sociale dhe mbrojtje të fëmijëve.	rregullt	17.12.2021

## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

29.	<b>Programë</b> për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve për vitin 2022.	rregullt	17.12.2021
30.	<b>Programë</b> për rregullimin e tokës ndërtimore në komunën e Tearcës për vitin 2022.	rregullt	17.12.2021
31.	<b>Programë</b> për ndriçim publik për vitin 2022.	rregullt	17.12.2021
32.	<b>Programë</b> vjetore për financimin e përpilimit të planeve urbanistike në territorin e komunës së Tearcës për vitin 2022.	rregullt	17.12.2021
33.	<b>Plan operativ</b> për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale dhe rrugicave në vendbanimet e territorit të komunës së Tearcës për sezonën dimërore 2021/2022.	rregullt	17.12.2021
34.	<b>Programë</b> e inspeksionit ndërtimor të komunës së Tearcës për vitin 2022.	rregullt	17.12.2021
35.	<b>Programë</b> për menaxhim me mbeturina në komunën e Tearcës për vitin 2022.	rregullt	17.12.2021
36.	<b>Programë</b> për aktivitetet e komunës së Tearcës nga lëmia e kulturës për vitin 2022.	rregullt	17.12.2021
37.	<b>Programë</b> për aktivitetet e komunës së Tearcës në lëmin e sigurimit social për vitin 2022.	rregullt	17.12.2021
38.	<b>Programë</b> për aktivitetet e komunës së Tearcës për përkrahjen e sektorit të OJQ-ve për vitin 2022.	rregullt	17.12.2021
39.	<b>Programë</b> për aktivitetet e komunës së Tearcës në sferën e sportit për vitin 2022.	rregullt	17.12.2021
40.	<b>Plani vjetor</b> për EE (efikasitet energjetik) në komunën e Tearcës për vitin 2022.	rregullt	17.12.2021
41.	<b>Programë</b> për aktivitetet e komunës së Tearcës në sferën e zhvillimit ekonomik lokal (ZHEL) për vitin 2022.	rregullt	17.12.2021
42.	<b>Vendim</b> për vërtetimin e tarifës rregullative për furnizim me ujë për pije për periudhën e rregulluar 2022-2024.	rregullt	17.12.2021
43.	<b>Vendim</b> për shlyerjen e borxhit për tatim në pronë (E.J. nga f.Dobrosht).	rregullt	17.12.2021
44.	<b>Përfundim</b> për refuzimin e kërkesës Shoqata e invalidëve të punës "TRUDBENIK"-Tetovë.	rregullt	17.12.2021
45.	<b>Buxheti</b> i komunës së Tearcës për vitin 2022.	rregullt	28.12.2021

## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

46.	<b>Vendim</b> për realizimin e Buxhetit të komunës së Tearcës për vitin 2022.	rregullt	28.12.2021
47.	<b>Programë</b> për punë e Këshillit të komunës së Tearcës për vitin 2022.	rregullt	28.12.2021
48.	<b>Programë</b> për punë të komunës së Tearcës për vitin 2022.	rregullt	28.12.2021
49.	<b>Programë</b> për hapjen, rekonstruktimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe rrugicave në territorin e komunës së Tearcës për vitin 2022.	rregullt	28.12.2021
50.	<b>Vendim</b> për ndarjen e dhuratave dhe mirënjohjeve.	rregullt	28.12.2021
51.	<b>Vendim</b> për dhënien e ndihmës financiare (A.J., B.M., R.S.).	rregullt	28.12.2021
52.	<b>Përfundim</b> për refuzimin e kërkesës (parashtruar nga grup qytetarësh f.Odër).	rregullt	28.12.2021
53.	<b>Vendim</b> për ndarjen e mjeteve financiare.	rregullt	28.12.2021
54.	<b>Vendim</b> për përcaktimin e vlerës së pikëve për rrogat e nëpunësve shtetëror për vitin 2022.	rregullt	28.01.2022
55.	<b>Vendim</b> për përcaktimin e maksimumit të arkës për vitin 2022.	rregullt	28.01.2022
56.	<b>Rregullore</b> për mënyrën e dhënies së ndihmës financiare të njëhershme dhe mbështetjes financiare për persona fizik.	rregullt	28.01.2022
57.	<b>Vendim</b> për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e vlefshmërisë së Kontratës bazë për koncesion nr.08-639/1 nga 14.07.2006.	rregullt	28.01.2022
58.	<b>Vendim</b> për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për vërtetimin dhe vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë elementare si dhe fatkeqësi tjera.	rregullt	28.01.2022
59.	<b>Vendim</b> për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për vërtetimin dhe vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë elementare si dhe fatkeqësi tjera.	rregullt	28.01.2022
60.	<b>Vendim</b> për zbatimin e dekretit dhe menaxhimit me energjinë elektrike në pajtim me dekretin për gjendje krize.	rregullt	28.01.2022
61.	<b>Vendim</b> për shfuqizimin e Përfundimit për refuzimin e kërkesës për veprim me statusin juridik të objektit të ndërtuar pa leje.	rregullt	28.01.2022

## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

62.	<b>Vendim</b> për shlyerjen e boxhit për tatim në pronë.	rregullt	28.01.2022
63.	<b>Vendim</b> për fillimin e procedurës për përpunimin e projektit urbanistik jashtë përfshirjes së planit urbanistik për PK nr.1966, 1988 KK Nerasht, me destinim D1 dhe D3 - sport dhe rekreacion.	rregullt	28.01.2022
64.	<b>Vendim</b> për ridestinimin e mjeteve të Buxhetit të komunës së Tearcës për vitin 2022.	rregullt	21.02.2022
65.	<b>Përfundim</b> për miratimin e Raportit për analizë paraprake të elementeve themelore për themelimin e PPP-KONCESION për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të ngurta komunale në komunën e Tearcës.	rregullt	21.02.2022
66.	<b>Vendim</b> për shitjen e mjetit motorik HYUNDAI LC ACCENT në pronësi të komunës së Tearcës.	rregullt	21.02.2022
67.	<b>Vendim</b> për shitjen e mjetit motorik CHEVROLET SPARK në pronësi të komunës së Tearcës.	rregullt	21.02.2022
68.	<b>Vendim</b> për fillimin e procedurës për përgatitjen e dokumentacionit teknik për rrugën lokale dhe trotuarit përkaj rrugës lokale Nerasht-Dobrosht.	rregullt	21.02.2022
69.	<b>Vendim</b> për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për realizimin e Buxhetit të komunës së Tearcës për vitin 2022.	rregullt	11.03.2022
70.	<b>Llogaria përfundimtare</b> e komunës së Tearcës për vitin 2021.	rregullt	11.03.2022
71.	<b>Përfundim</b> për miratimin e llogarisë përfundimtare të NP "Higjiena" Tearcë për vitin 2021.	rregullt	11.03.2022
72.	<b>Përfundim</b> për miratimin e llogarisë vjetore të SHFK "Eqrem Çabej" f.Slatinë për vitin 2021.	rregullt	11.03.2022
73.	<b>Përfundim</b> për mosmiratimin e llogarisë vjetore të SHFK "Kiril Pejçinoviç" f.Tearcë për vitin 2021.	rregullt	11.03.2022
74.	<b>Përfundim</b> për miratimin e llogarisë vjetore të SHFK "Faik Konica" f.Dobrosht për vitin 2021.	rregullt	15.03.2022 (vazhdimi i seancës së VII)
75.	<b>Përfundim</b> për miratimin e llogarisë vjetore të SHFK "Asdreni" f.Gllgjë për vitin 2021.	rregullt	15.03.2022 (vazhdimi i seancës së VII)



## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

76.	<b>Përfundim</b> për miratimin e llogarisë vjetore të SHFK "Ismail Qemali" f.Nerasht për vitin 2021.	rregullt	15.03.2022 (vazhdimi i seancës së VII)
77.	<b>Vendim</b> për formimin dhe emërimin e anëtarëve të trupit pjesëmarrës nga sfera e urbanizmit.	rregullt	15.03.2022 (vazhdimi i seancës së VII)
78.	<b>Vendim</b> për shlyerjen e borxhit për tatim në pronë (I.Sh.nga f.Tearcë).	rregullt	15.03.2022 (vazhdimi i seancës së VII)
79.	<b>Vendim</b> për shlyerjen e borxhit për tatim në pronë (R.F. nga f.Sllatinë).	rregullt	15.03.2022 (vazhdimi i seancës së VII)
80.	<b>Vendim</b> për lirim nga taksa komunale për ndriçim publik (L.LI nga f.Nerasht).	rregullt	15.03.2022 (vazhdimi i seancës së VII)
81.	<b>Vendim</b> për kompenzimin e anëtarit të Këshillit të komunës për pjesëmarrje në lidhjen e martesave.	rregullt	15.03.2022 (vazhdimi i seancës së VII)
82.	<b>Vendim</b> për shkarkimin dhe emërimin e kryetarit të Komisionit për vërtetimin dhe vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë elementare si dhe fatkeqësive tjera në territorin e komunës së Tearcës.	rregullt	11.04.2022
83.	<b>Raport</b> për realizimin e Programës vjetore për hapjen, rekonstruktimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe rrugicave në territorin e komunës së Tearcës për vitin 2021.	rregullt	11.04.2022
84.	<b>Raport</b> për realizimin e Programës për ndriçim publik për vitin 2021.	rregullt	11.04.2022
85.	<b>Vendim</b> për formimin e Komisionit të përkohshëm për konstatimin e gjendjes reale me ndiçimin publik në vendbanimet e komunës së Tearcës.	rregullt	11.04.2022
86.	<b>Vendim</b> për vërtetimin e nevojës nga sjellja e dokumentacionit planor urbanistik për përshtatshmërinë e destinimit të tokës ndërtimore për PK nr.1661/2 dhe PK nr.2261/1 KK Neproshten.	rregullt	11.04.2022
87.	<b>Plani aksional</b> dyvjeçar për barazi gjinore në komunën e Tearcës për periudhën 2022-2023.	rregullt	11.04.2022
88.	<b>Vendim</b> për shlyerjen e borxhit për tatim në pronë (M.Gj. nga f.Tearcë).	rregullt	11.04.2022
89.	<b>Vendim</b> për mbështetje financiare (H. M. nga f.Sllatinë).	rregullt	11.04.2022
90.	<b>Vendim</b> për përcaktimin e projekteve me prioritet për realizim në f.Sllatinë për vitin 2022.	rregullt	11.04.2022

## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

91.	<b>Përfundim</b> për miratimin e raportit kuartal për periudhën raportuese (kumulative) për kuartalin nga 01.01.2022 deri 31.03.2022.	rregullt	10.05.2022
92.	<b>Vendim</b> për iniciimin e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve në Këshillin rinor.	rregullt	10.05.2022
93.	<b>Strategjia lokale</b> për zhvillimin e të rinjve në komunën e Tearcës, 2022-2025.	rregullt	10.05.2022
94.	<b>Vendim</b> për miratimin e studimit të fizibilitetit për arsyeshmërinë e ndarjes së kontratës për partneritet publiko privat për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave komunale në gjithë territorin e komunës së Tearcës.	rregullt	10.05.2022
95.	<b>Vendim</b> për fillimin e procedurës për ndarjen e kontratës për partneritet publiko privat-koncesion për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave komunale në gjithë territorin e komunës së Tearcës.	rregullt	10.05.2022
96.	<b>Vendim</b> për caktimin e çmimit të shërbimeve komunale për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave komunale nga amvisëritë në gjithë territorin e komunës së Tearcës.	rregullt	10.05.2022
97.	<b>Përfundim</b> për ndryshimin dhe plotësimin e Planit vjetor për punësim në komunën e Tearcës për vitin 2022.	rregullt	10.05.2022
98.	<b>Përfundim</b> për miratimin e llogarisë përfundimtare të Qendrës për zhvillim të rajonit planor të Pollogut (QZHRPP) për vitin 2021.	rregullt	28.06.2022
99.	<b>Përfundim</b> për miratimin e Raportit vjetor për implementimin e programit për zhvillim të rajonit planor të Pollogut 2021-2026 për vitin 2021.	rregullt	28.06.2022
100.	<b>Programë</b> njëvjeçare në lëminë e menaxhimit me tokën ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në rajonin e komunës së Tearcës për vitin 2022.	rregullt	28.06.2022
101.	<b>Konkluzion</b> për dhënien e Pëlqimit të Planit vjetor për punësim për vitin 2023 në SHFK "Ismail Qemali" f.Nerasht.	rregullt	28.06.2022

## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

<b>102.</b>	<b>Vendim</b> për dhënien e Pëlqimit për formimin e paraleleve të pastra me numër më të vogël se 20 nxënës në SHKF “Eqrem Çabej” f.Sllatinë nga klasa e I - IX për vitin shkollor 2022/2023.	rregullt	28.06.2022
<b>103.</b>	<b>Vendim</b> për dhënien e Pëlqimit për formimin e paraleleve të pastra me numër më të vogël se 20 nxënës në SHKF “Kiril Pejçinoviq” f.Tearcë nga klasa e I - IX për vitin shkollor 2022/2023.	rregullt	28.06.2022
<b>104.</b>	<b>Vendim</b> për dhënien e Pëlqimit për formimin e paraleleve të pastra me numër më të vogël se 20 nxënës në SHKF “Asdreni” f.Gllogjë nga klasa e I - IX për vitin shkollor 2022/2023.	rregullt	28.06.2022
<b>105.</b>	<b>Vendim</b> për dhënien e Pëlqimit për formimin e paraleleve të pastra me numër më të vogël se 20 nxënës në SHKF “Faik Konica” f.Dobrosht nga klasa e I - IX për vitin shkollor 2022/2023.	rregullt	28.06.2022
<b>106.</b>	<b>Vendim</b> për dhënien e Pëlqimit për formimin e paraleleve të pastra me numër më të vogël se 20 nxënës në SHKF “Ismail Qemali” f.Nerasht nga klasa e I - IX për vitin shkollor 2022/2023.	rregullt	28.06.2022
<b>107.</b>	<b>Vendim</b> për dhënien e Pëlqimit për formimin e paraleleve të kombinuara në SHKF “Eqrem Çabej” f.Sllatinë nga klasa e I - V për vitin shkollor 2022/2023.	rregullt	28.06.2022
<b>108.</b>	<b>Vendim</b> për dhënien e Pëlqimit për formimin e paraleleve të kombinuara në SHKF “Faik Konica” f.Dobrosht nga klasa e I - V për vitin shkollor 2022/2023.	rregullt	28.06.2022
<b>109.</b>	<b>Vendim</b> për dhënien e Pëlqimit për formimin e paraleleve të kombinuara në SHKF “Kiril Pejçinoviq” f.Tearcë nga klasa e I - V për vitin shkollor 2022/2023.	rregullt	28.06.2022
<b>110.</b>	<b>Vendim</b> për dhënien e Pëlqimit për formimin e paraleleve të kombinuara në SHKF “Asdreni” f.Gllogjë nga klasa e I - V për vitin shkollor 2022/2023.	rregullt	28.06.2022

## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

111.	<b>Vendim</b> për shkarkimin e anëtarit të Komisionit për vërtetimin dhe vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë elementare si dhe fatkeqësitë tjera në territorin e komunës së Tearcës.	rregullt	28.06.2022
112.	<b>Përfundim</b> për miratimin e Elaboratit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore-shiu dhe breshëri që përfshiu komunën e Tearcës.	rregullt	28.06.2022
113.	<b>Vendim</b> për dhënie të pëlqimit të Planit vjetor për punësime në komunën e Tearcës për vitin 2023.	rregullt	29.07.2022
114.	<b>Vendim</b> për miratimin e Programit vjetor të punës së SHFK “Faik Konica” f.Dobrosht, për vitin shkollor 2022/23.	rregullt	29.07.2022
115.	<b>Vendim</b> për miratimin e Programit vjetor të punës së SHFK “Eqrem Çabej” f.Sllatinë për vitin shkollor 2022/23.	rregullt	29.07.2022
116.	<b>Vendim</b> për miratimin e Programit vjetor të punës së SHFK “Kiril Pejçinoviç” f.Tearcë, për vitin shkollor 2022/23.	rregullt	29.07.2022
117.	<b>Vendim</b> për miratimin e Programit vjetor të punës së SHFK “Ismail Qemali” f.Nerasht, për vitin shkollor 2022/23.	rregullt	29.07.2022
118.	<b>Vendim</b> për miratimin e Programit vjetor të punës së SHFK “Asdreni” f.Glogjë, për vitin shkollor 2022/23.	rregullt	29.07.2022
119.	<b>Përfundim</b> për pranimin e Raportit të Komisionit për zbatimin e procedurës për partneritet publiko privat-koncesion për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave komunale në gjithë territorin e komunës së Tearcës dhe konfirmimin e të gjitha veprimeve të ndërmara në procedurën nr.0001/2022.	rregullt	29.07.2022
120.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e ofertës më të volitshme pas procedurës për dhënie e kontratës për themelimin e partneritetit publiko privat-koncesion për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave komunale në gjithë territorin e komunës së Tearcës.	rregullt	29.07.2022

## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

121.	<b>Vendim</b> për autorizimin e kryetarit të komunës së Tearcës për nënshkrimin e Kontratës për themelimin e partneritetit publiko privat-koncesion për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave komunale në gjithë territorin e komunës së Tearcës.	rregullt	29.07.2022
122.	<b>Rregullore</b> për punë të trupit Participues nga sfera e urbanizmit në komunën e Tearcës.	rregullt	07.09.2022
123.	<b>Vendim</b> për formimin e Komisionit për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve.	rregullt	07.09.2022
124.	<b>Rebalans</b> i Buxhetit të komunës së Tearcës për vitin 2022.	rregullt	07.09.2022
125.	<b>Vendim</b> për pagesë të mjeteve në vlerë mbi 50.000,00 denarë nga rezervat e parapara në Buxhetin e komunës së Tearcës për vitin 2022.	rregullt	07.09.2022
126.	<b>Vendim</b> për dhënie të pëlqimit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit vjetor për punësim në komunën e Tearcës për vitin 2022.	rregullt	07.09.2022
127.	<b>Vendim</b> për ndarjen e mjeteve financiare (M.R. nga f.Slatinë).	rregullt	07.09.2022
128.	<b>Vendim</b> për ndarjen e mjeteve financiare (Klubit të futbollit "Rinia" f.Përshefc).	rregullt	07.09.2022
129.	<b>Vendim</b> për ndarjen e mjeteve financiare (Klubit të futbollit "Sharri 1979" f.Gllgjë).	rregullt	07.09.2022
130.	<b>Vendim</b> për zbatimin e procedurës për shpronësimin e tokës.	rregullt	07.09.2022
131.	<b>Përfundim</b> për refuzimin e kërkesës së parashtruar nga firma private për falje të borxhit.	rregullt	07.09.2022
132.	<b>Vendim</b> për dhënie të pëlqimit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit vjetor për punësim në komunën e Tearcës për vitin 2022.	rregullt	06.10.2022
133.	<b>Konkluzion</b> për dhënien e Pëlqimit për Planin vjetor për punësime në NP Higjiena-Tearcë për vitin 2023.	rregullt	06.10.2022
134.	<b>Plan operativ</b> për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe rrugicave në territorin e komunës së Tearcës në kushte dimri për 2022/2023.	rregullt	06.10.2022
135.	<b>Vendim</b> për verifikimin e mandateve të anëtarëve në Këshillin lokal të të rinjve në komunë të Tearcës.	rregullt	06.10.2022

## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

136.	<b>Vendim</b> për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për përpilimin e Programës për punën e Këshillit të komunës së Tearcës për vitin 2023.	rregullt	06.10.2022
137.	<b>Vendim</b> për ridestininim të mjeteve të Buxhetit të komunës së Tearcës për vitin 2022.	rregullt	06.10.2022
138.	<b>Vendim</b> për ndarjen e mjeteve financiare (Shkollës së futbollit “Nerashti” f.Nerasht).	rregullt	06.10.2022
139.	<b>Vendim</b> për ndarjen e mjeteve financiare (Klubit të karatesë “Shkëndija” Tetovë).	rregullt	06.10.2022
140.	<b>Vendim</b> për lirim të pjesëshëm nga pagesa e tatimit (S.R. nga f.Dobrosht).	rregullt	06.10.2022
141.	<b>Vendim</b> për kqyrje në vend ngjarrje dhe përcaktimin e gjendjes faktike.	rregullt	06.10.2022
142.	<b>Rebalans</b> i Buxhetit të komunës së Tearcës për vitin 2022.	rregullt	15.11.2022
143.	<b>Program</b> për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik në territorin e komunës së Tearcës për vitin 2023.	rregullt	15.11.2022
144.	<b>Vendim</b> për vërtetimin e nevojës nga sjellja e dokumentacionit planor urbanistik për përshtatshmërinë e destinimit të tokës ndërtimore për PK nr.973 dhe pjesë PK nr.2262/1 KK Neproshten.	rregullt	15.11.2022
145.	<b>Vendim</b> për vërtetimin e nevojës nga sjellja e dokumentacionit planor urbanistik për përshtatshmërinë e destinimit të tokës ndërtimore për PK nr.752/4 KK Tearcë.	rregullt	15.11.2022

Gjatë periudhës njëvjeçare janë miratuar edhe 13 Procesverbale të seancave të Këshillit të komunës së Tearcës.

Të gjitha aktet juridike janë të shpallura në “Fletoren zyrtare të komunës së Tearcës” dhe të njëjtat publikohen edhe në web faqen e komunës së Tearcës.

## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

Komisione të formuar nga Këshilli i komunës së Tearcës

Zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të komisioneve të Këshillit komunal bëhet me propozimin e komisionit për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërime. Komisioni për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërime e jep propozimin në Këshill, në bazë të propozimeve për anëtarë të komisioneve të paraqitura paraprakisht nga partitë politike, iniciativat qytetare, etj, të përfshira në Këshill. Në zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të komisioneve të Këshillit mbahet llogari për zbatimin e parimit të përfshirjes në mënyrë proporcionale të të gjitha subjekteve dhe iniciativave qytetare si dhe duke mos anashkaluar edhe përfaqësimin gjinor.

Komisionet dhe numri i anëtarëve	
Komisioni	Numri i anëtarëve
Komisioni verifikues për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit të komunës së Tearcës.	Kryetari dhe 2 anëtarë
Komisioni kandidues për propozimin e kandidatit për kryetar të Këshillit të komunës së Tearcës.	Kryetari dhe 4 anëtarë
Komisioni për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërime.	Kryetari dhe 4 anëtarë
Komisioni për financa, buxhet dhe zhvillim ekonomik lokal.	Kryetari dhe 4 anëtarë
Komisioni për planifikim dhe rregullimin e hapësirës dhe mbrojtje të mjedisit jetësor.	Kryetari dhe 4 anëtarë
Komisioni për punë komunale dhe komunikacion.	Kryetari dhe 4 anëtarë
Komisioni për veprimtari shoqërore.	Kryetari dhe 4 anëtarë
Komisioni statutar-juridik.	Kryetari dhe 4 anëtarë
Komisioni për dhurata dhe mirënjohje.	Kryetari dhe 4 anëtarë
Komisioni për arsim.	Kryetari dhe 4 anëtarë
Komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë elementare.	Kryetari dhe 8 anëtarë
Këshilli drejtues i NP "Higjiëna"-Tearcë.	5 anëtarë
Komisioni për mundësi të njëjta mes femrave dhe meshkujve.	Kryetari dhe 6 anëtarë
Këshilli mbikqyrës për punë materialo-financiare.	Kryetari dhe 4 anëtarë
Komisioni për marrëdhënie mes bashkësive.	Kryetari dhe 4 anëtarë
Komisioni për mbrojtje shëndetësore, mbrojtje sociale dhe mbrojtje të fëmijëve.	Kryetari dhe 4 anëtarë
Këshilli lokal i të rinjve në komunë të Tearcës.	5 anëtarë
Komisioni i përkohshëm për konstatimin e gjendjes reale me ndiçimin publik në vendbanimet e komunës së Tearcës.	5 anëtarë
Këshilli lokal për preventivë.	Kryetari dhe 9 anëtarë
Komisioni për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve në komunën e Tearcës.	

## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

Komisioni verifikues për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit të komunës së Tearnës.


Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
<b>Genc Misimi</b>	
Kryetar	<b>2</b>
ANËTARË:	
<b>Gzim Azemi</b>	
<b>Metin Useini</b>	



Anëtarët e komisionit verifikues i zgjedh Këshilli komunal pas propozimit të anëtarit më të vjetër të Këshillit, i cili kryeson seancën e parë, ose me propozim të anëtarit të Këshillit. Komisioni verifikues përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë. Komisioni verifikues në bazë të informimit të Komisionit zgjedhor komunal, çertifikatave të dorëzuara nga anëtarët e Këshillit për zgjedhjen e tyre dhe vërtetimin e identitetit të tyre, paraqet raport me propozim për verifikim të mandatit të anëtarit të Këshillit.

Komisioni kandidues për propozimin e kandidatit për kryetar të Këshillit të komunës së Tearnës.

Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
<b>Erzen Elezi</b>	
Kryetar	<b>1</b>
ANËTARË:	
<b>Gjulten Qazimi</b>	
<b>Oliver Georgievski</b>	
<b>Rami Selmani</b>	
<b>Sezgin Sherifi</b>	




Anëtarët e komisionit Kandidues i zgjedh Këshilli i komunës menjëherë pas verifikimit të mandateve të anëtarëve të Këshillit. Anëtarët e komisionit zgjedhen me shumicë votash nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në seancë. Komisioni Kandidues përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë, të cilët zgjedhen me propozim të anëtarëve të Këshillit. Komisioni Kandidues me shumicë votash nga përbërja e vet propozon një ose më shumë kandidat për kryetar të Këshillit.



## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

**Komisioni për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërimë.**

Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
<b>Festim Elmazi</b>	
Kryetar	<b>6</b>
ANËTARË:	
<b>Valmira Selimi</b>	
<b>Imer Imeri</b>	
<b>Ilço Tofillovski</b>	
<b>Nesrine Qazimi</b>	



**Komisioni për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërimë shqyrton dhe përgatit propozime të cilat u përkasin çështjeve të mandatit dhe imunitetit, shqyrton dhe përgatit propozime për zgjedhje, emërimë dhe shkarkime në kompetencë të Këshillit të komunës, etj. Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit i zgjedh Këshilli i komunës në seancën e tij të parë.**

**Komisioni për financa, buxhet dhe zhvillim ekonomik lokal.**

Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
<b>Festim Elmazi</b>	
Kryetar	<b>6</b>
ANËTARË:	
<b>Gjulten Qazimi</b>	
<b>Genc Misimi</b>	
<b>Llazar Gjeorgjievski</b>	i jashtëm
<b>Arsime Fetishi</b>	e jashtëm



**Komisioni për financa, buxhet dhe zhvillim ekonomik lokal i shqyrton çështjet lidhur me financimin e komunës, miratimin e buxhetit dhe të llogarisë përfundimtare të buxhetit të komunës së Tearcës, çështjet nga planifikimi dhe programimi i zhvillimit ekonomik lokal si dhe kompetenca tjera të parapara me Rregulloren e Këshillit të komunës së Tearcës dhe Statutin e komunës.**

## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

Komisioni për planifikim dhe rregullimin e hapësirës dhe mbrojtjen e ambientit jetësor.


Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
<b>Rijad Mustafi</b>	
Kryetar	<b>3</b>
ANËTARË:	
<b>Sezgin Sherifi</b>	
<b>Ilço Tofillovski</b>	
<b>Behar Halimi</b>	i jashtëm
<b>Halil Rexhepi</b>	i jashtëm



Komisioni për planifikim dhe rregullimin e hapësirës dhe mbrojtjen e ambientit jetësor ka kompetenca në rregullimin e çështjeve nga sfera e urbanizmit, duke përfshijë ndryshimet e planeve urbanistike për fshat, jashtë planit urbanistik, planet urbanistike për infrastrukturë, etj.


Komisioni për punë komunale dhe komunikacion.

Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
<b>Rami Selmani</b>	
Kryetar	/
ANËTARË:	
<b>Valon Idrizi</b>	
<b>Ilço Tofillovski</b>	
<b>Besjan Pajaziti</b>	i jashtëm
<b>Ermira Jusufi</b>	e jashtme



Komisioni për veprimtari shoqërore.

Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
<b>Erzen Elezi</b>	
Kryetar	/
ANËTARË:	
<b>Metin Useini</b>	
<b>Rijad Mustafi</b>	
<b>Bob Petrushevski</b>	i jashtëm
<b>Sihana Amiti</b>	e jashtme



## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

### Komisioni Statutar-Juridik.


Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
<b>Besnik Osmani</b>	
Kryetar	/
ANËTARË:	
<b>Amet Ziberi</b>	
<b>Erzen Elezi</b>	
<b>Ferduze Sheapi</b>	e jashtme
<b>Emilia Nikollovska</b>	e jashtme



Komisioni Statutar-juridik përcakton propozimin e Statutit të komunës, shqyrton nismat dhe propozimet për ndryshimin e Statutit, përcjell zbatimin e tij dhe i shqyrton çështjet parimore me karakter statutar, përcakton propozimin e Rregullores së punës së Këshillit, përgatit propozim-mendime për propozim-vendimet që i përkasin komunës dhe shqyrton edhe akte të tjera të përgjithshme në kompetencë të Këshillit të komunës, etj.

### Komisioni për dhurata dhe mirënjohje.

Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
<b>Gzim Azemi</b>	
Kryetar	1
ANËTARË:	
<b>Valmira Selimi</b>	
<b>Nesrine Qazimi</b>	
<b>Katerina Popovska</b>	e jashtme
<b>Leonita Qazimi</b>	e jashtme



### Komisioni për arsim.

Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
<b>Imer Imeri</b>	
Kryetar	2
ANËTARË:	
<b>Gjulten Qazimi</b>	
<b>Valmira Selimi</b>	
<b>Mirjeta Aliti</b>	e jashtme
<b>Blend Xhemaili</b>	i jashtëm



## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

**Komisioni për mundësi të njëjta mes femrave dhe meshkujve.**

Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
<b>Valmira Selimi</b>	
Kryetare	<b>2</b>
ANËTARË:	
<b>Arjeta Shasivari</b>	
<b>Gjulten Qazimi</b>	
<b>Nesrine Qazimi</b>	
<b>Oliver Georgievski</b>	
<b>Merita Ameti</b>	
<b>Gajur Salih</b>	



**Komisioni për vërtetimin dhe vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë elementare si dhe fatkeqësitë tjera në territorin e komunës së Tearcës.**

Emri dhe mbiemri	Dalje në terren
<b>Saladin Zeqiri</b>	
Kryetar	<b>2</b>
ANËTARË:	
<b>Jusuf Muradi</b>	
<b>Besnik Osmani</b>	
<b>Genc Misimi</b>	
<b>Rijad Mustafi</b>	
<b>Orce Nikollovski</b>	i jashtëm
<b>Mevludin Mustafi</b>	i jashtëm
<b>Tafije Idrizi</b>	e jashtme
<b>Mahir Ismaili</b>	i jashtëm

Komisioni organizon grumbullimin e materialit të tërësishëm për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga fatkeqësitë elementare në territorin e komunës së Tearcës, i përpunon materialet, përpunon rezultatet përfundimtare të mbledhura sipas lëmive, përgatit raport me propozim-masa për mënjanimin e dëmeve nga fatkeqësitë elementare dhe rreziqet e tjera të përgjithshme.

**Këshillit mbikqyrës për kontrollë të punëve materialo-financiare.**

Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
<b>Besnik Osmani</b>	
Kryetar	<b>/</b>
ANËTARË:	
<b>Festim Elmazi</b>	
<b>Arian Hakiki</b>	
<b>Ilmiasan Hasipi</b>	i jashtëm
<b>Harbin Memishi</b>	i jashtëm

**Këshilli drejtues i NP "Higjiena"-Tearcë.**

Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
	<b>/</b>
ANËTARË:	
<b>Amet Arifi</b>	
<b>Berat Xhelili</b>	
<b>Metin Useini</b>	
<b>Asan Seadini</b>	
<b>Goce Trpevski</b>	

Burimi i informacionit: "Fletorja zyrtare e komunës së Tearcës".

## KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS

Komisionit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive në Këshillin e komunës së Tearcës.

Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
<b>Berat Xhelili</b>	
Kryetar	/
<b>ANËTARË:</b>	
<b>Zharko Ilievski</b>	
<b>Mamut Huseini</b>	
<b>Suada Huseini</b>	
<b>Samir Sabiti</b>	

Komisioni për mbrojtje shëndetësore, mbrojtje sociale dhe mbrojtje të fëmijëve.

Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
<b>Erzen Elezi</b>	
Kryetar	/
<b>ANËTARË:</b>	
<b>Nesrine Qazimi</b>	
<b>Valmira Selimi</b>	
<b>Elmira Shafii</b>	e jashtme
<b>Jehona Rexhepi</b>	e jashtme

Këshilli lokal i të rinjve në komunë Tearcës.

Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
	/
<b>ANËTARË:</b>	
<b>Altrim Selami</b>	
<b>Alketa Mustafi</b>	
<b>Ardita Asani</b>	
<b>Karolina Maksimovska</b>	
<b>Blend Xhemaili</b>	

Këshilli lokal për preventivë.

Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
Kryetari i komunës	
<b>Kryetar</b>	/
<b>ANËTARË TË PËRHERSHËM:</b>	
Kryetari i Këshillit të komunës	
Komandanti i stacionit policor, përgjegjës për rajonin e Tearcës.	
Udhëheqësi i departamentit për veprimtari shoqërore dhe publike.	
Kryetarët e komisioneve të Këshillit.	
<b>ANËTARË TË PËRKOHSHËM:</b>	
Embija Iljazi	
Jetmir Bilalli	
Abdulla Ramadani	
Amet Aliu	
Zoran Jakovski	

Komisioni i përkohshëm për konstatimin e gjendjes reale me ndiçimin publik në vendbanimet e komunës së Tearcës.

Emri dhe mbiemri	Mbledhjet e mbajtura
	/
<b>ANËTARË:</b>	
<b>Besnik Osmani</b>	
<b>Rijad Mustafi</b>	
<b>Amet Ziberi</b>	
<b>Metin Useini</b>	
<b>Ilço Tofillovski</b>	

Burimi i informacionit: "Fletaja zyrtare e komunës së Tearcës".

**Procesi i vendimmarrjes në Këshill**

Këshilli i komunës së Tearcës është organi më i lartë vendimmarrës në komunë të Tearcës. Kryetari i Këshillit zgjedhet nga rradhët e anëtarëve të Këshillit me propozim të Komisionit kandidues. Kryetari i Këshillit zgjedhet me votim publik nëse Këshilli nuk vendos që votimi të jetë i fshehtë.

Kryetari i Këshillit kujdeset për organizimin e punës së Këshillit; për zbatimin e Rregullores së Këshillit dhe jep sqarime në lidhje me zbatimin e saj; për sendërtimin e të drejtave të anëtarëve të Këshillit; për zbatimin e parimit për punë transparente të Këshillit, etj. Kryetari i Këshillit i nënshkruan vendimet dhe aktet tjera juridike që i miraton Këshilli dhe më pas ia dorëzon Kryetarit të komunës për shpallje dhe proklamim. Votimi në Këshill mund të jetë i hapur dhe i fshehtë. Votimi i hapur në Këshill bëhet me ngritjen e dorës dhe me deklaram individual. Deklarimi individual mund të bëhet atëherë kur këtë do ta kërkojë një anëtarë i Këshillit me mbështetjen e 4 anëtarëve të tjerë. Votimi individual bëhet me deklarimin e çdo anëtari të thirrur të Këshillit “për” ose “kundër” propozimit ose me “përmbajtje” nga votimi.

Votimi i fshehtë në Këshill bëhet me fletëvotime ku secili fletëvotim duhet të jetë në të njëjtën madhësi dhe ngjyrë.

Organet e komunës së Tearcës gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre sjellin akte të përgjithshme dhe akte të veçanta.

Me aktet e përgjithshme në mënyrë burimore rregullohen marrëdhëniet, të drejtat dhe obligimet e qytetarëve dhe personave juridik në suaza të kompetencave të komunës.

Organet e komunës së Tearcës sjellin edhe akte të veçanta kur vendosin në procedurë administrative ose kur bëhet zgjedhje apo emërim i personave, si dhe raste të parapara me ligj ose dispozitë tjetër.

Si akte të përgjithshme që sjell Këshilli i komunës së Tearcës janë: statuti, programet, planet, vendimet dhe dispozitat tjera juridike.

Procedura për miratimin e akteve të përgjithshme fillon me paraqitjen e propozimit për miratimin e aktit të përgjithshëm.

Propozimi për miratimin e aktit juridik duhet të përmbajë bazën juridike për miratim dhe shkaqet për të cilat duhet të miratohet.

Propozimin për miratimin e aktit të përgjithshëm nga kompetenca e Këshillit, e përcaktuar me Statutin e komunës, e japin Kryetari i komunës, organi drejtues, trupi punues i Këshillit ose shërbimet publike, institucionet dhe ndërmarrjet që i themelon Këshilli i komunës. Propozimi për miratimin e aktit të përgjithshëm mund t'i jepet Kryetarit të Këshillit në formë të shkruar ose gojarisht në seancë.

Propozimi për miratimin e aktit juridik i dorëzohet trupit punues përkatës ose organit kompetent në afat prej 3 ditë nga dita e dhënies së tij dhe më pas ky propozim i dorëzohet Kryetarit të komunës.

Këshilli i komunës e shqyrton propozimin për miratimin e aktit të përgjithshëm me qëndrimin e trupit punues ose organit drejtues dhe e përcakton arsyeshmërinë dhe nevojën për miratimin e aktit juridik. Nëse Këshilli vlerëson se nuk ka bazë dhe nevojë për miratimin e aktit juridik, për këtë e informon propozuesin.

Kur Këshilli i komunës së Tearcës do ta përcaktojë arsyeshmërinë dhe nevojën për miratimin e aktit të përgjithshëm, automatikisht cakton përpilues të aktit dhe nëse me propozimin për miratim është dorëzuar edhe propozimi i aktit juridik, Këshilli bën diskutim për miratimin e të njëjtit. Këshilli i komunës së Tearcës, programet, vendimet dhe aktet tjera juridike i miraton në procedurë të përcaktuar me ligj. Propozimet për ndryshimin dhe plotësimin e vendimeve miratohen me shumicën e votave nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në raste të veçanta, Këshilli ndjek edhe procedurë urgjente për marrjen e vendimeve nëse kjo është e domosdoshme për të penguar fatkeqësitë elementare, rrethanat tjera të jashtëzakonshme ose kur është me interes të komunës.

Rregullat, vendimet dhe aktet tjera juridike të Këshillit shpallen në "Fletoren zyrtare të komunës së Tearcës". Vendimet dhe aktet tjera juridike të miratuara nga Këshilli i komunës hyjnë në fuqi ditën e tetë nga e dita e shpalljes në "Fletoren zyrtare të komunës së Tearcës", nëse me Rregulloren e Këshillit dhe me Statutin e komunës nuk është përcaktuar ndryshe.